



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

RAPORT MONITORIMI I REKOMANDIMEVE 2024



Këshilli i Investimeve është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me synim intensifikimin e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit dhe promovimin e mirë qeverisjes. Platforma mbështetet nga një sekretariat i përbërë prej një grupi të pavarur profesionistësh të zgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit. Financimi aktual për Sekretariatin e K, sigurohet nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Materiali është përgatitur nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Xaira Shurdha, Eksperte e Ndërlidhjes dhe Monitorimit nën udhëheqjen e Drejtores së Sekretariatit, znj. Diana Leka (Angoni) me mbështetjen e z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor e Rregullator dhe znj. Elida Fara, Eksperte Ekonomie. Materiali është redaktuar nga znj. Elisa Lula, Specialiste e Komunikimit pranë Sekretariatit, duke ofruar mbështetje edhe në përgatitjen e dizajnit.

Informacioni i përmbledhur në këtë raport është përpiluar bazuar në aktivitetet monitoruese, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BERZH-it apo SECO-s. Materiali (tekst apo imazh), nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar në të.

Tiranë, Janar 2025

RAPORT MONITORIMI I REKOMANDIMEVE

2024

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)
Drejtores e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva
Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al


Elida Fara
Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha
Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula
Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Albania Investment Council ALInvestCouncil Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

PËRMBAJTJA

01	Përmbledhje Ekzekutive	06-07
02	Metodologjia	08-09
03	Konteksti	10-11
04	Progresi i rekomandimeve	12-29
	4.1 Pasqyrë e rekomandimeve 2015-2024	12
	4.2 iniciativat avokuese të sekretariatit të KI mbi përmbushjen e rekomandimeve	14
	4.3 Bashkëpunimi me Këshillin Ekonomik Kombëtar	15
	4.4 Ecuria e rekomandimeve gjatë vitit 2024	16
05	Aneks 1	30-31

SHKURTIME

AIE	Agjencia për Inovacionin dhe Ekselencën
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punesimit dhe Aftësive
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor Rural
BE	Bashkimi Evropian
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EBRD	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KEK	Këshilli Ekonomik Kombëtar
KI	Këshilli i Investimeve
KM	Këshilli i Ministrave
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHAAP	Ministri i Shtetit për Antikorrupsionin dhe Administratën Publike
MSHQV	Ministria e Shtetit për Qeverisjen Vendore
MSHSKB	Ministri e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
NMVM	Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme
SECO	Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike
SKI	Sekretariati i Këshillit të Investimeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me agjendën vjetore të Këshillit të Investimeve (KI), gjatë vitit 2024 u zhvilluan tre mbledhje plenare për të analizuar dhe diskutuar sfidat me të cilat përballlet sektori privat. Diskutimet u përqendruan në administrimin fiskal, inovacionin, produktivitetin, konkurrueshmërinë, lehtësimin e aksesit të produkteve jo-ushqimore shqiptare në tregjet e huaja—veçanërisht në BE—si dhe përmirësimin e aksesit në financim. Si rezultat, Këshilli i Investimeve miratoi 24 rekomandime të reja.

Zhvillimet kryesore në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të KI përfshijnë:

- » Ndikim në pesë dokumente strategjike dhe politike¹ përmes propozimit të përfshirjes së 91 rekomandimeve të KI. Nga të cilët, 22 u përfshinë në këto dokumente, specifikisht në “Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave 2024-2027” dhe “Agjendën Kombëtare të Reformave 2024-2027”, duke nxitur zbatimin e tyre në përputhje me objektivat dhe afatet kohore të qeverisë.
- » Miratim i nëntë ndërhyrjeve ligjore², të propozuara përmes rekomandimeve të KI, në lidhje me tre strategji, dy ligje (“Për Inspektimet”; “Për Turizmin”) dhe katër vendime dhe akte të tjera ligjore në fushën e energjisë së rinovueshme, bujqësisë dhe tatimit të dyfishtë.
- » Forcim i bashkëpunimit me Këshillin Ekonomik Kombëtar (KEK), i cili u ristrukturua nën drejtimin e Kryeministrit dhe u koordinua nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Në këtë kuadër, u shkëmbyen materiale dhe analiza të KI mbi reformën e inspektimeve, informalitetin, aksesin në financë dhe industrinë e fasonit, duke kontribuar në agjendën e KEK-ut dhe përmirësimin e klimës së biznesit.

1 Nga iniciativat avokuese të Sekretariatit të KI gjatë vitit 2024.

2 Detajuar në seksionin 4.4.

- » 24 rekomandime të KI patën ecuri, duke sjellë ndërhyrje pozitive në sektorët prioritarë, ku veçojmë:
 - Turizmi – *Përmirësimi i formalizimit dhe standardeve të cilësisë*: Ndryshimet në Ligjin Nr. 30/2024 nxisin standardizimin e shërbimeve dhe mundësojnë certifikimin e detyrueshëm për ofruesit e akomodimit; *Të dhëna të përmirësuara për hartimin më të saktë të Politikave*: Strukturimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të turizmit, dhe krijimi i “Komitetit të Statistikave të Turizmit”.
 - Bujqësia dhe Agro-Përpunimi – *Digjitalizimi i hartave të tokës bujqësore*: Zbatimi i platformave GIS për optimizimin e përdorimit të tokës dhe orientimin e fermerëve; *Bashkëpunimi rajonal dhe certifikimet*: Njohja reciproke e certifikatave fitosanitare në Ballkanin Perëndimor, e mbështetur nga projekti SEED+ për testimin e certifikimit elektronik; *Përmirësimi i kapaciteteve të agro-përpunimit*: Akreditimi i ISUV për analizën e mbetjeve të pesticideve dhe produkteve të tjera bujqësore, duke forcuar eksportet dhe rritur standardet e sigurisë ushqimore.
 - Energjitika – *Promovimi i energjisë së rinovueshme*: Mbështetje ligjore dhe rregullatore, duke përfshirë miratimin e vendimeve si p.sh. vendimi nr. 695/2024, që lehtësojnë prodhimin dhe stimulimin e energjisë së rinovueshme; *Liberalizimi i tregut të energjisë*: Bërja funksionale e Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX) dhe integrimi me tregjet rajonale.
 - Transformimi Digjital në të gjitha sektorët – *Shërbimet publike*: Zgjerimi i sistemeve të pagesave online përmes e-Albania për 17 shërbime dhe përmirësimi i integritetit me institucionet bankare; *Open Banking*: Licencimi i institucionit të parë të Open Banking, duke nxitur gjithëpërfshirjen financiare dhe konkurrencën; *Siguria dhe mbrojtja e të dhënave*: Zbatimi i planeve të rikuperimit dhe zgjidhjeve Data Loss Prevention (DLP) për të siguruar platformat digjitale.
 - Punësimi dhe Zhvillimi Ekonomik – *Platforma e ndërmjetësimit të punës*: Platforma e centralizuar **www.puna.gov.al** sjell mundësi shtesë ndërveprimi duke lehtësuar informimin midis punëdhënësve dhe punëkërkuarëve; *Ndërkombëtarizimi i biznesit*: promovimi i ndërmarrjeve shqiptare përmes pjesëmarrjes në forume dhe panaire ndërkombëtare të biznesit.
 - Reforma e Inspektimeve – *Integrimi strukturor*: Miratimi i Ligjit Nr. 99/2024, i cili integron reformat e inspektimit me përmirësime strukturore, duke rritur profesionalizmin dhe besimin në proceset e ankimimit.
- Progres i kufizuar, vërehet në lidhje me rekomandimet e dhëna në mbledhjet mbi “Potencialet e Investimeve” dhe “Sigurinë Ligjore të Pronës”, duke reflektuar sfidat ekzistuese në përmbushjen dhe përmirësimin e këtyre aspekteve në kontekstin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik dhe ligjor të vendit.
- Megjithëse janë evidentuar zhvillime, shoqatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë duhet të rrisin kapacitetet e tyre për një standard më të lartë ndërveprimi në proceset e konsultimit të politikave publike në vend.

Për të përshpejtuar zbatimin e rekomandimeve, këtë vit Sekretariati ka intensifikuar përpjekjet në avokimin dhe promovimin e llogaridhënies dhe transparencës përmes kontributit në dokumente politikash, pjesëmarrjes në evente të nivelit të lartë, angazhimit të një numri më të madh aktorësh dhe krijimit të partneriteteve të reja.

METODOLOGJIA

Raporti i monitorimit evidenton ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KI të miratuara gjatë periudhës 2015-2024, dhe më specifikisht progresin e zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2024. Ky raport paraqet një përmbledhje të nismave të ndërmarra dhe raportuara nga institucionet publike përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të KI dhe nuk vlerëson ndikimin e tyre në sektorin privat. Përmbajtja bazohet në të dhëna cilësore dhe sasiore të mbledhura gjatë vitit 2024 përmes aktiviteteve të mëposhtme:

I – AKTIVITETE MONITORUESE NË NDËRVEPRIM ME INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE:

- (i) Shkëmbimi zyrtar i informacionit përmes korrespondencës me shkrim pas çdo mbledhjeje të KI-së, duke adresuar rekomandimet specifike që priten të zbatohen nga institucionet përkatëse;
- (ii) Monitorim periodik i nivelit të zbatimit të rekomandimeve specifike çdo tremujor.

Takimet direkte dhe komunikimi përmes korrespondencës me shkrim, postës elektronike dhe telefonatave të shpeshta kanë qenë në fokus të bashkëpunimit me institucionet që raportuan zyrtarisht aktivitetet e tyre mbi përmbushjen ose jo të rekomandimeve përkatëse.³

II – PUNË HULUMTUESE

Përveç korrespondencës zyrtare, u konsultuan një sërë dokumentash zyrtare me qëllim identifikimin e ndryshimeve përkatëse lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të KI. Më konkretisht, dokumentet e konsultuara përfshinin (1) Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), (2) Vendime të Ministrave, (3) Ligje, akte nënligjore (ndryshimet e tyre),

(4) strategji të miratuara/draftuara, (5) Plane veprimi, (6) Raporte të progresit të BE-së, dhe (7) Raporte ndërkombëtare. Lista e dokumenteve kryesore të konsultuara gjendet në Shtojcën 1.

III – BURIME DYTËSORE INFORMACIONI

Një nga aktivitetet më të shpeshta ka qenë monitorimi i përditshëm i faqeve të internetit, platformave, rrjeteve sociale e medias vizive, si burime informacioni ku promovohen aktivitetet e ndërmarra nga institucionet publike, si dhe platformat e konsultimeve, artikujt në gazeta, njoftimet për shtyp, lajmet, etj. Përveçse një mjet dytësor për verifikimin e informacionit lidhur me përmbushjen apo jo të rekomandimeve të KI, këto burime shërbejnë gjithashtu si matës i nivelit të transparencës së institucioneve zbatuese dhe nivelit të angazhimit të tyre me sektorin privat. Disa nga faqet e internetit të konsultuara janë renditur në Shtojcën 1.

IV – PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Çdo informacion i marrë nga komunikimi me institucionet, dokumentet justifikuese apo publikimet online, regjistrohen në bazën e të dhënave të rekomandimeve. Baza e të dhënave përditësohet me informacionet e reja që diskutohen midis ekspertëve të Sekretariatit për dakordësim mbi statusin e rekomandimeve përkatëse. Çdo tremujor, gjenerohet një raport faktik mbi ecurinë e rekomandimeve.

V – RAPORTIMI

Gjetjet nga aktivitetet monitoruese dhe përditësimi i progresit iu raportohet anëtarëve të KI⁴ dhe publikohen çdo gjashtëmuaj në faqen e internetit dhe rrjetet sociale të KI.

PARIMET E MONITORIMIT⁵

Parimet që udhëheqin aktivitetet monitoruese janë:

- Bashkëpunim i ndërsjelltë me të gjithë aktorët, partnerët dhe institucionet qeveritare.
- Transparencë e të dhënave dhe informacionit për anëtarët e KI, donatorët dhe palët e tjera të përfshira. Konsultimi i të paktën dy burimeve të pavarura për të saktësuar informacionin e marrë.
- Shkëmbim opinionesh, informacionesh, dialog mbi përditësimet dhe dakordësim i gjithë stafit të Sekretariatit mbi ecurinë e përmbushjes së rekomandimeve (si nga ana cilësore ashtu edhe sasiore).
- Argumentimi i rezultateve bazuar në të dhëna të faktuara në rrugë zyrtare.

4 Përmes e-mail dhe/ose prezantimit në mbledhje gjatë vitit.
5 Referencë "Manuali i Monitorimit" i KI

3 Detajuar në Shtojcën 1.

KONTEKSTI

Këshilli i Investimeve operon në mënyrë aktive në Shqipëri prej rreth nëntë vitesh, duke shërbyer si një lehtësues komunikimi mes sektorit publik dhe atij privat. Objektivi i tij kryesor është të përmirësojë dialogun, të zbusë asimetritë e informacionit dhe të sigurojë pjesëmarrjen aktive të sektorit privat në proceset e reformave ekonomike dhe strukturore. KI luan një rol kyç në nxitjen e një mjedisi biznesi transparent, të favorshëm dhe miqësor ndaj investimeve. Gjithashtu, ai përpiqet të kontribuojë në rritjen e mundësive të punësimit në të gjithë sektorët ekonomikë të vendit. Duke zvogëluar distancat mes aktorëve të ndryshëm, KI synon të krijojë një atmosferë bashkëpunimi që promovon rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Objektivat kryesore të parashikuara për Këshillin që prej fillimit të tij janë:

(1) KI të rrisë besueshmërinë e ndërsjelltë mes palëve: Si një platformë e strukturuar dialogu mes sektorit publik e atij privat, KI bazon punën e tij në fakte e synon të gjenerojë besim mes të gjithë aktorëve të përfshirë, duke ndikuar në forcimin e ekonomisë shqiptare.

KPI: Reagime pozitive nga përfaqësuesit e qeverisë, shoqatat e biznesit, bizneset dhe numri i mbledhjeve të Këshillit.

(2) KI të jetë një mjet efikas reformues: Qeveria dhe komuniteti i biznesit ta shohin e ta përdorin KI si një mjet efikas për reformim të qëndrueshëm ekonomik.

KPI: Numri i rekomandimeve të dhëna të miratuara nga Qeveria; Numri i propozimeve për përmirësimin e klimës së investimeve të pranuar nga autoritetet përkatëse; Numri i ligjeve, rregulloreve, politikave të ndryshuara ose të miratuara bazuar në rekomandimet e Këshillit.

Veprimtaritë monitoruese në këtë raport janë përqendruar në mbledhjen e të dhënave dhe analizën e informacionit që lidhen me këto dy indikatorë, me qëllim që të:

- Informojë palët e përfshira dhe t'i përditësojë ato mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëshuara gjatë mbledhjeve të KI, më konkretisht gjatë vitit 2024.
- Sigurojë palët që ato çfarë janë propozuar janë marrë ose po merren në konsideratë.
- Mbështesë vendimmarrjen e donatorëve dhe drejtuesve të Sekretariatit përmes ofrimit të informacionit.

QËLLIMI I MONITORIMIT

Raporti mbulon gjithë periudhën e veprimtarisë së KI (2015-2024), duke marrë parasysh se disa rekomandime të lëshuara në vitet e mëparshme kërkojnë kohë për t'u përmbushur, ndërsa rekomandimet e lëshuara gjatë vitit të kaluar kërkojnë kryesisht të paktën 6 muaj ose më shumë që të miratohen dhe përpunohen nga institucionet vendimmarrëse. Në seksionet e mëposhtme paraqitet një përmbledhje e rezultateve të periudhës 9-vjeçare dhe një pjesë specifike në lidhje me ecurinë gjatë vitit 2024.

04

PROGRESI I REKOMANDIMEVE

4.1 – PASQYRË E REKOMANDIMEVE 2015-2024

Që nga fillimi i aktivitetit, KI ka organizuar tridhjetë e pesë mbledhje, ku janë trajtuar çështje specifike të biznesit, priorizuar e përzgjedhur nga votat e anëtarëve të KI. Anëtarët kontribuojnë në mënyrë aktive duke vlerësuar temat e propozuara, ndarë komentet dhe pikëpamjet e tyre, identifikuar sfidat e lidhura me biznesin dhe duke ofruar zgjidhje, sugjerime dhe rekomandime konkrete gjatë mbledhjeve plenare.

Rreth 13% e totalit të rekomandimeve janë sugjeruar nga anëtarët e KI-së, përmes bashkëveprimit në mbledhjet plenare të KI-së, ndërsa 87% e rekomandimeve bazohen në analizat paraprake të Sekretariatit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse përfshin hulumtime të raporteve kombëtare e ndërkombëtare, ndërveprim të drejtpërdrejtë me përfaqësues dhe ekspertë nga sektori privat, lehtësim të grupeve të punës të organizuara në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, biznese e ekspertë, analiza të të dhënave nga anketat e Sekretariatit, si dhe rekomandimet e ekspertëve dhe diskutimeve teknike (fokus grupeve) mbi gjetjet paraprake para mbledhjeve plenare.

PROFILI I REKOMANDIMEVE

Rekomandimet e miratuara në KI, synojnë ndërhyrje në pesë nivele: (i) Strategjike, (ii) Institucionale, (iii) Ligjore, (iv) Transparencë e Ndërgjegjësim, dhe (v) Politika.

Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve (40%) vënë theksin mbi stabilizimin dhe qëndrueshmërinë e institucioneve, promovimin e një qasjeje të koordinuar, vizion të përbashkët nga struktura të integruara, forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, rritjen e kapaciteteve, përmirësimin e standardit dhe cilësisë së shërbimeve. Pra, në kontekstin e përgjithshëm të rekomandimeve, reflektohet kërkesë e vazhdueshme për forcimin e kornizës institucionale dhe rritjen e efikasitetit operacionale.


25% e totalit të rekomandimeve fokusohet në ndërhyrje ligjore, duke përfshirë më shumë se 41 ligje dhe akte ligjore, duke theksuar angazhimin e KI në reformat ligjore. Ndërkohë,

21% e rekomandimeve propozojnë zgjidhje strategjike për çështje të rëndësishme që lidhen me informalitetin, turizmin, pronësinë, aftësitë e forcës së punës, aksesin në financë, investimet publike dhe strategjike, eksportet, sektorët prioritarë dhe fusha të tjera kyçe.

Në aspektin sektorial, 60% e rekomandimeve totale adresojnë ndërhyrje që ndikojnë ndjeshëm në të gjithë sektorët e biznesit. Pjesa tjetër e rekomandimeve fokusohet në sektorët prioritarë për zhvillimin ekonomik si në Turizëm (7%), Bujqësi (7%), Energji (6%), Ndërtim (5%) dhe Agro-përpunim (5%). Këto rekomandime propozojnë një qasje strategjike të orientuar në nxitjen e formalizimit dhe krijimin e kuadrit ligjor mbështetës, të qëndrueshëm dhe të thjeshtë për bizneset.

Nga 350 rekomandime gjithsej, 47% e tyre janë zbatuar në masën 70-100%. Ndërsa 17% e tyre janë aktualisht në proces zbatimi, duke reflektuar përpjekjet e vazhdueshme për përmbushjen e tyre. Rreth 36 % e rekomandimeve mbeten të pazbatuara, ku shumica prej tyre janë dhënë në mbledhjet “Mbi Sigurinë Ligjore të Pronës” – me 12 rekomandime të pazbatuara; “Mbi Potencialet e Investimeve” – me 18 rekomandime të parealizuar; “Mbi Burimet Alternative të Energjisë” – me 11 rekomandime të paplotësuar.

Grafik 1. Situata e rekomandimeve, Dhjetor 2024 (në %)



Gjatë viteve të fundit, vlen të përmenden disa ndryshime pozitive të ndikuara nga rekomandimet e KI, si:

Bujqësia dhe Agro-përpunimi - Ka pasur përpjekje për krijimin e një mjedisi më të favorshëm për sektorin bujqësor, për të inkurajuar formalizimin dhe investimet në bujqësi, duke nxitur produktivitetin dhe qëndrueshmërinë. Aktivitetet e përpunimit të agro-produkteve me vlerë të shtuar janë promovuar, ndërkohë që formalizimi i bizneseve është inkurajuar përmes skemave kombëtare mbështetëse, pajisjes me karta elektronike dhe subvencionimit të naftës për fermerët.

Turizmi dhe Energjia - Përpjekjet për të intensifikuar potencialin turistik të Shqipërisë janë forcuar përmes promovimit të shtuar në nivele ndërkombëtare, duke përmirësuar imazhin e vendit si destinacion turistik. Në sektorin e energjisë, ndërhyrjet ligjore kanë

6 40% e totalit prej 350 rekomandimesh

mbështetur adoptimin e energjisë së rinovueshme, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt qëndrueshmërisë dhe diversifikimit të burimeve energjetike në Shqipëri.

Zhvillimi i Biznesit dhe Punësimi - Rritja e kapaciteteve institucionale të AIDA-s ka ndikuar në aksesin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-ve) në fonde përmes ofrimit të informacionit të përditësuar mbi programet e mbështetjes financiare dhe ndërkombëtarizimit. Procedurat doganore janë modernizuar me publikimin e listave të çmimeve referencë, përmirësimin e kushteve dhe lançimin e Platformës Digjitale të Rimbursimit të TVSH-së, si dhe mundësinë e paraqitjes së kërkesave online. Janë prezantuar gjithashtu stimuj për punësimin, duke përfshirë subvencione për punësimin e individëve të papunë dhe një mekanizëm për indeksimin e pagave në administratën publike, që pritet të ketë ndikim pozitiv edhe në sektorin privat.

Transformimi Digjital dhe Qeverisja - Ka pasur ecuri në nxitjen e tregtisë elektronike, zgjerimin e mbulimit kombëtar të rrjetit broadband, dhe krijimin e Agjencisë për Inovacionin dhe Ekselencën (AIE) për të përmirësuar aksesin në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Ndikimet në fushën e qeverisjes përfshijnë rritjen e transparencës në nivel lokal, përmirësimin e aksesit në informacion dhe zhvillimin e trajnimeve mbi raportimin financiar të bashkive. Po ashtu, është përmirësuar cilësia e shërbimeve publike online (si p.sh. lejet e ndërtimit), duke reflektuar një shtysë më të gjerë drejt digjitalizimit.

4.2 INICIATIVAT AVOKUESE TË SEKRETARIATIT TË KI MBI PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE

Përveç aktiviteteve monitoruese, Sekretariati i KI intensifikoi përpjekjet e tij për avokim me qëllim nxitjen e institucioneve përgjegjëse për plotësimin e rekomandimeve, duke kontribuar aktivisht në disa dokumente të rëndësishme politikash si dhe në aktivitete të nivelit të lartë. Nga dokumentet e komentuara, veçojmë:

- » Propozimi i 12 rekomandimeve në Strategjinë Afat-Mesme të të Ardhurave 2024-2027 dhe Planin e Veprimit 2024-2027. Propozimet kryesore përfshin unifikimin e procedurave tatimore nën një ligj të ri fiskal, automatizimin dhe modernizimin e proceseve të administratës tatimore, dhe nxitjen e inovacionit në sektorin privat përmes politikave fiskale të targetuara. Po ashtu, u sugjeruan masa për formalizimin e ekonomisë, inkurajimin e përdorimit të sistemeve të pagesave elektronike dhe forcimin e mekanizmave të tregut të punës, për të siguruar praktika të drejta punësimi dhe përputhje të forcës punëtore me kërkesat e tregut. *Strategjia u miratua përmes VKM nr. 847 në dhjetor 2024, dhe 10 nga rekomandimet e propozuara nga KI u përfshinë në planin e veprimit të tre viteve në vijim.*
- » Sugjerimi i 15 rekomandimeve për t'u përfshirë në dokumentin politik "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027" në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Mekanizmi i Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor". *Në tetor 2024, nga sugjerimet e propozuara, 11 rekomandime të KI-së u përfshinë në dokumentin përfundimtar të miratuar* (VKM nr. 621), duke u bërë pjesë e tre shtyllave kryesore të Agjendës së Reformave: (i) Modernizimi i *klimesë së biznesit* me strategji të përditësuara të të ardhurave; digjitalizimi i sistemeve kadastrale; miratimi i ligjit të investimeve⁷ në përputhje edhe me standardet e BE-së. (ii) *Kapitali njerëzor*, ku reformat të synojnë përmirësimin e arsimit dhe edukimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës, përmes përditësimit të kurikulave; miratimit të Strategjisë së Specializimit

Inteligjent; krijimit të Smart Labs; zbatimit të rregulloreve për vendosjen e 5G; zbatimit të skemave të granteve për zgjidhje të gjelbra dhe digjitale për NVM-të dhe start-up-et; (iii) *Energjia dhe tranzicioni i gjelbër* - duke u fokusuar në funksionalizimin e tregjeve të energjisë elektrike brenda ditës.

- » Pjesëmarrja në konsultimet dhe grupet teknike të punës të organizuara mbi "Strategjinë e Specializimit Inteligent dhe prioritizimi i 59 rekomandimeve, duke theksuar forcimin e bashkëpunimit midis qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë për të nxitur inovacionin dhe zhvillimin teknologjik. Propozimet kryesore përfshinin krijimin e programeve të trajnimit për aftësi digjitale, promovimin e investimeve në TIK, dhe ngritjen e platformave ndër-sektoriale për të nxitur kërkimin dhe zhvillimin. U theksua gjithashtu nevoja për programe të edukimit profesional të personalizuar për t'u përputhur me kërkesat e tregut të punës dhe për inkurajimin e NVM-ve të adoptojnë teknologji inovative. Gjithashtu, rekomandimet theksuan integrimin e Shqipërisë në zinxhirët globalë të vlerës duke mbështetur sektorët e orientuar drejt eksportit dhe përmirësimin e praktikave bujqësore përmes koordinimit më të mirë.
- » Kontribut me 5 rekomandime në dokumentin "Prioritetet e Politikës së Konkurrueshmërisë për Shqipërinë" të përgatitur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në kuadër të Programit të Reformave Strukturore "Prioritetet e Politikës së Konkurrueshmërisë për Ballkanin Perëndimor" (WBIF). Rekomandimet theksuan forcimin e mbështetjes për NVM-të, veçanërisht në sektorë të rëndësishëm si turizmi dhe ndërtimi; nxitjen e iniciativave të gjelbra dhe efikase për energjinë; zhvillimin e një plani kombëtar për ndërhyrje prioritare duke u fokusuar në investimet në energjinë e rinovueshme, sigurinë energjetike, dhe përputhshmërinë me legjislationin. Gjithashtu u theksua nevoja për platforma të bashkëpunimit lokal dhe rajonal, duke përfshirë bashkitë, bizneset, komunitetet dhe institucionet financiare për të nxitur zhvillimin ekonomik rajonal.
- » Propozimi i 10 rekomandimeve në Konferencën Kombëtare: "Shqipëria - Një portë për biznesin global", me fokus në zhvillimin ekonomik dhe ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve shqiptare. Propozimet synonin forcimin e integritetit të NMVM-ve në tregjet ndërkombëtare përmes iniciativave strategjike, sugjeronin krijimin e databazave specifike sektoriale për NMVM-të për të personalizuar trajnime mbi gatishmërinë për eksport dhe hyrjen në tregje; mbështetje institucionale për përmirësimin e menaxhimit dhe ndërkombëtarizimin përmes forcimit të partneriteteve; mbështetje për kërkime tregjesh; krijimin e një portali kombëtar të eksporteve. Gjithashtu, u sugjeruan masa për rritjen e pjesëmarrjes së NMVM-ve në evente ndërkombëtare, për të vlerësuar dhe përmirësuar stimujt e investimeve dhe për të promovuar praktikatat e ekonomisë së gjelbër.

4.3 BASHKËPUNIMI ME KËSHILLIN EKONOMIK KOMBËTAR

Në dhjetor 2023, Këshilli Ekonomik Kombëtar u ristrukturua nën drejtimin e Kryeministrit dhe u koordinua nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, që është gjithashtu anëtar i përhershëm i Këshillit të Investimeve. U krijuan disa grupe pune dhe Sekretariati i KI ndau materiale dhe analiza mbi tema të përbashkëta pune dhe me interes për të dy këshillat, si mbi:

- » **Informalitetin** – Informacioni i ndarë përfshinte materialet e përgatitura dhe të publikuara nga Sekretariati i KI në 10 mbledhje, kryesisht të fokusuar në propozimet

teknike për informalitetin në dy sektorë kryesorë si turizmi dhe bujqësia. U shkëmbyen gjithsej 43 rekomandime, së bashku me perceptimin e sektorit privat, të analizuar përmes 7 anketave.

- » **Aksesin në financë** – Informacioni i ndarë përfshinte gjetjet dhe rekomandimet e adresuara në 8 mbledhje të KI dhe analizat nga 4 anketa, ku është shqyrtuar aksesin në financë për NMVM-të, jo vetëm në aspektin e disponueshmërisë së kredive nga sistemi bankar, por gjithashtu në kontekstin e mundësive të financimit me fonde publike dhe jo-publike.
- » **Inspektimet** – Materialet mbi inspektimet ishin të fokusuar në 28 rekomandime të përgatitura mbi këtë temë në janar 2019 dhe në 6 mbledhje të tjera, si dhe disa informacione mbi sfidat lidhur me inspektimet, të analizuar përmes 4 anketave. Fokusi ishte në formalizimin dhe nevojën për zbatim rigoroz të ligjit, veçanërisht në analizat e ankesave administrative.
- » **Sfidat në sektorin fason** – Duke vënë theksin te strategjitë për rritjen e konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë ekonomike, Sekretariati i KI-së solli në vëmendje 7 rekomandime që propozojnë: financimin e ‘Modeleve të Kontratave të Rrjetit’ për të mbështetur ndërkombëtarizimin dhe krijimin e klasterëve në industri specifike, siç është veshmbathja ushtarake; krijimin e mekanizmave për të zbutur pushimet kolektive nga puna përmes zyrave të punës; zbatimin e një sistemi vjetor të indeksimit të pagave për sektorin privat; si dhe reformimin e sistemeve të ngurta të kontributeve sociale dhe shëndetësore për të luftuar punësimin informal. Gjithashtu, u propozuan stimuj për ri-investim, si përjashtime tatimore, zgjatja e periudhave të bartjes së humbjeve tatimore dhe shfrytëzimi i pronave shtetërore për krijimin e qendrave të trajnimit të fuqisë punëtore. Një rëndësi e veçantë iu kushtua nevojës për të nxitur bashkëpunimin sektorial të bizneseve për të siguruar akses në fondet e inovacionit dhe zhvillimit, duke mundësuar më tej që Shqipëria të tërheqë investime dhe të shfrytëzojë në mënyrë efektive mekanizmat financiarë të BE-së dhe ndërkombëtarë.

4.4 ECURIA E REKOMANDIMEVE GJATË 2024

Në vitin 2024, gjatë tre mbledhjeve plenare, u miratuan njëzet e katër rekomandime të reja, bazuar në analiza paraprake të Sekretariatit:

1. **“Sfidat e sektorit privat: administrata fiskale, produktiviteti dhe inovacioni”** – Nxitja e debatit mbi sfidat kryesore të sipërmarrjes (kryesisht NMVM-ve) për të investuar në inovacion dhe produktivitet. Analiza u përqendrua në ndërveprimin me administratën tatimore dhe ndikimin e reformës së fiskalizimit, identifikimi i ndërhyrjeve ndërsektoriale në politikat dhe administratën fiskale, si dhe produktiviteti i kompanive.
2. **“Për konkurrueshmërinë dhe rritjen e aksesit në tregje të produkteve jo-ushqimore shqiptare me standarde evropiane”** – Në këtë mbledhje, rekomandimet u përqendruan mbi përmirësimin e aksesit në informacion; udhëzimet mbi kërkesat e përgjithshme dhe specifike të legjislacionit për përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret teknike; mbështetja institucionale për NMVM-të për t’u përshtatur me standardet dhe kapacitetet ekzistuese lokale; forcimi i procedurave të zbatimit, procesit të inspektimit dhe përmirësimi i kompetencave dhe integritetit të inspektorëve.


3. **“Për përmirësimin e instrumenteve të financimit, perceptime dhe sugjerime nga komuniteti i biznesit dhe sektori financiar”** – Në këtë mbledhje, ndërhyrjet e propozuara u fokusuan në përmirësimin e mbledhjes dhe transparencës së të dhënave për NMVM-të për të mundësuar politika më të mira dhe zhvillimin e produkteve të përshtatura sipas nevojave të tyre. Rekomandimet përfshinin vlerësimin e procesit të zbatimit dhe ndikimit të Skemave të Garancisë Sovrane të lëshuara përmes bankave tregtare private, shqyrtimin e zgjerimit të Skemave të Garancisë për të lehtësuar zhvillimin e produkteve financiare inovative, përsheptimin e përpjekjeve për digjitalizimin e shërbimeve bankare, zgjerimin e programeve të edukimit financiar me fokus te NMVM-të, thjeshtimin e procesit të kreditimit, rishikimin e procedurave burokratike dhe dokumentacionit, rishqyrtimin e rolit të punonjësve të bankave në këshillimin financiar, hartimin dhe miratimin e një ligji të posaçëm për krijimin e Byrosë së Kredive; si dhe plotësimin e kuadrit ligjor për të rritur potencialisht opsionet e financimit.

Bazuar në një proces të vazhdueshëm ndjekjeje dhe komunikimesh formale me institucionet publike, 24 rekomandime janë marrë në konsideratë prej tyre, me një angazhim të qëndrueshëm për zbatimin e tyre. Nga ky total, 12 rekomandime janë vlerësuar si të përmbushura në masën 70-100%, ndërsa 12 të tjera janë në proces zbatimi.

Institucionet publike kanë shfaqur gatishmëri për të ofruar informacion mbi përditësimin e rekomandimeve. Megjithatë, përgjigjet e marra kanë qenë të përgjithshme dhe shpesh ka munguar ofrimi i shifrave konkrete apo ndikimeve të matshme. Për përditësimin e informacionit në lidhje me rekomandimet e KI-së, janë kontaktuar njëmbëdhjetë institucione, nga të cilat gjysma kanë dhënë komente mbi statusin përkatës të rekomandimeve: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Kadastrës.

Siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm, 50% e rekomandimeve me progres pozitiv janë përqendruar në ndërhyrje në nivel institucional, ndërsa 29% trajtojnë ndërhyrje në nivel strategjik.

Grafik 2. Ecuria e rekomandimeve sipas kategorisë, dhjetor 2024 (në %)




Në lidhje me dinamikat ligjore që ndikuan në ecurinë e 17% të rekomandimeve me progres, theksohen kryesisht:

- » Në prill 2024, u miratua Ligji Nr. 30/2024, i cili solli ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar. Ndryshimet kishin për qëllim formalizimin e sektorit dhe rritjen e standardeve dhe cilësisë së strukturave akomoduese.
- » Në qershor 2024, u miratuan ndryshimet në VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e llojeve, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, magazinimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe të kafshëve, në tokën bujqësore”, duke ndikuar mbi ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore.
- » U miratua Ligji nr. 99/2024, dt. 12.09.2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ligji harmonizon reformën e inspektimit me administratën publike dhe standardet e BE-së, duke synuar forcimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, duke përfshirë mekanizma konsultimi me bizneset për të vlerësuar ndikimet rregullatore dhe duke përmirësuar unifikimin e ankesave të inspektorateve nën Inspektoratin Qendror, me synim rritjen e profesionalizmit, pavarësisë dhe besimit.
- » U miratua Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 11/1, datë 27.11.2024, i cili sjell disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 11, datë 23.07.2024, “Për zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal”.
- » U miratua Vendimi nr. 695, datë 13.11.2024, “Për miratimin e masave mbështetëse, rregullave dhe procedurave për përfitimin nga masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, duke përcaktuar masat mbështetëse për promovimin e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme diellore dhe të erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve që do të përfitojnë prej tyre.
- » U miratua Vendimi nr. 696, datë 13.11.2024, i cili përcakton kuadrin ligjor “Për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të Operatorit të Energjisë së Rinovueshme SH.A.”, duke detajuar përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të kësaj strukture.
- » Miratimi i “Strategjisë Afat-Mesme të të Ardhurave 2024-2027 dhe Planit të Veprimit 2024-2027” përmes VKM nr. 847 në dhjetor 2024.
- » U miratua përmes VKM nr. 621 në tetor 2024 “Agjenda Kombëtare e Reformës 2024-2027” brenda instrumentit të Bashkimit Evropian “Mekanizmi i Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor”.

Në lidhje me ecurinë e rekomandimeve në aspektin sektorial, gjatë vitit 2024, shfaqet një model i qartë: 63% e rekomandimeve me progres⁸ kanë pasur një ndikim në të gjithë sektorët. Ndër sektorët më të ndikuar nga këto rekomandime veçohen Turizmi, Bujqësia dhe Energjia. Tabela 1, e bashkëngjitur në aneks, detajon ndërhyrjet kryesore të evidencuara në sektorët kryesorë.

8 Në total, 24 rekomandime gjatë vitit 2024 (të zbatuara dhe në proces).


Grafik 3. Rekomandimet me progres sipas sektorëve, në vitin 2024 (në %9)



Aktualisht, janë 124 rekomandime ende të paplotësuara. Këto rekomandime janë kategorizuar dhe paraqitur në detaje në grafikun më poshtë, bazuar në temat ku janë trajtuar.

Pjesa më e madhe e rekomandimeve të paplotësuara janë dhënë në mbledhjet mbi “Sigurinë Ligjore të Pronës” (10% e totalit), “Potencialet e Investimeve” (15%) dhe “Burimet Alternative të Energjisë” (9%).

Grafik 4. Rekomandimet e pazbatuara, Dhjetor 2024



9 Mbi totalin prej 44 rekomandime me progres pozitiv gjatë vitit 2024.

Disa nga rekomandimet ende të pazbatuara, por që konsiderohen të rëndësishme për t'u zbatuar, janë:

- » **Hartimi dhe miratimi i një Strategjie kundër ekonomisë informale.** Dokumenti duhet të shoqërohet me një plan veprimi të detajuar, që përfshin analiza dhe qasje sektoriale, afate të qarta kohore dhe institucione përgjegjëse të mirëpërcaktuar. Gjithashtu, strategjia duhet të konsultohet dhe koordinohet me përfaqësuesit e biznesit për të siguruar efektivitetin e saj.
- » **Regjistrimi në ASHK i pasurive të patundshme nën administrimin e bashkive.** Duhet të sigurohet publikimi i tyre dhe transparenca mbi statusin e procesit të transferimit dhe regjistrimit, si dhe përdorimi i tyre në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe në funksion të gjenerimit të të ardhurave.
- » **Kadastra digjitale për pasuritë shtetërore duhet të jetë online dhe pa kufizim qasjeje për publikun.** Si një kërkesë e vazhdueshme e bizneseve dhe qytetarëve dhe në funksion të transparencës, kjo masë do të ishte e mirëpritur dhe do të shërbente për llogaridhënien ndaj tatimpaguesve. Përgatitja dhe publikimi i fondit të pasurive shtetërore për investime (sipas nenit 31 të Ligjit Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike” dhe VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015).
- » **Monitorimi dhe rritja e transparencës në koordinimin e Investimeve Publike (qendrore dhe lokale)** në përputhje me strategjitë e sektorëve prioritarë, për të mundësuar optimizimin e investimeve.
- » **Forcimi i bashkëpunimit sektorial të biznesit,** duke nxitur inovacionin dhe mundësitë për akses në fonde nga partnerë si COSME, BE dhe WBIF. Përmirësimi i angazhimit të shoqatave të biznesit dhe kapaciteteve menaxheriale, duke përmirësuar gjithashtu pjesëmarrjen e sektorit privat në politikat publike.
- » **Dhomat e tregtisë dhe shoqatat duhet të ofrojnë programe trajnimi të synuara për drejtuesit e NMVM-ve,** duke u fokusuar në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe mentorimin brenda organizatave. Duke theksuar investimet në teknologji dhe automatizim, është thelbësore të priorizohen trajnimi dhe zhvillimi i aftësive të stafit për të përmbushur nevojat në rritje të biznesit.
- » **Inkurajimi i politikave fiskale në nivel qendror** për ato ndërmarrje që kanë një buxhet dhe një numër të caktuar punonjësish të dedikuar për Kërkimin dhe Zhvillimin (KZh).
- » **Krijimi i një Portali Sektorial të Eksporteve** brenda kuadrit të Strategjisë së Eksporit që t'u ofrojë anëtarëve të komunitetit të biznesit: (i) informacion mbi tregjet e huaja; (ii) udhëzime për eksport dhe marketing në tregjet e huaja; (iii) akses në rrjetëzim me palë ndërkombëtare; (iv) këshilla për tregtinë e jashtme, transportin dhe shitjet në shumicë; (v) arkitektë dhe dizajn; (vi) përfaqësues tregtie/ndërmjetësues; (vii) oferta nga kompani të huaja; (viii) statistika mbi tregtinë e jashtme dhe situatën ekonomike.
- » **Automatizimi i shërbimeve të ofruara në nivel lokal** për të përditësuar në kohë reale (1) informacionin mbi detyrimet që paguhen dhe/ose mbarten nga bizneset, si dhe (2) informacionin mbi bizneset (administratorët). Krijimi i një platforme informuese për shkëmbimin e informacionit online midis bashkive dhe bankave të nivelit

të dytë. Unifikimi dhe standardizimi i formateve elektronike të urdhrave të bllokimit gjithashtu do të kontribuonte në përmirësimin e proceseve.

- » **Krijimi i skemave të sigurimit për produktet e biznesit bujqësor,** me shtetin si ndërmjetës. Për të zhvilluar sektorin e sigurimeve, sugjerohet që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) të gjenerojë informacion bazuar në të dhëna, risqe për çdo nën-sektor të bujqësisë, tabela me të dhëna mbi motin, reshjet, luhatjet e temperaturave. Kjo mund të arrihet përmes bashkëpunimit me stacione sinjalizuese dhe investime që menaxhojnë riskun në bujqësi.

Përsheptimi i progresit në implementimin e këtyre rekomandimeve do të kërkonte më shumë vëmendje, angazhim aktiv dhe bashkëpunim nga institucionet publike dhe private përgjegjëse.

Të dhënat e mëposhtme në **Tabelën 1** rendisin disa nga rekomandimet me ecuri pozitive gjatë vitit 2024 dhe masat specifike të ndërmarra për përmbushjen e tyre.

Rekomandime	Arrije	Impakti i Pritshëm
SEKTORI I TURIZMIT		
Standardizimi i cilësisë së shërbimit, përmes sqarimit/ specifikimit të kategorive dhe klasifikimit të subjekteve turistike.	Në prill 2024, u miratua Ligji Nr. 30/2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015, ‘Për Turizmin’,” duke sjellë ndryshime që synojnë formalizimin e sektorit dhe rritjen e standardeve dhe cilësisë së strukturave akomoduese. Gjithashtu, së bashku me shtimin e kategorive të reja të strukturave dhe detajimin e klasifikimit të tyre, tani është e detyrueshme që individët që japin dhoma, vila dhe apartamente me qira të marrin një certifikatë kualifikimi dhe një certifikatë klasifikimi nga Ministria para se të fillojnë aktivitetet e akomodimit. Megjithatë, ata nuk janë të detyruar të regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).	Nga këto iniciativa do të përfitojnë rreth 20,000+ biznese të angazhuara në shërbimet e akomodimit brenda sektorit të turizmit, duke rritur konkurrencën e tyre.
Strukturimi i statistikave të sektorit të turizmit përmes përmirësimit të procesit të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave të konsoliduara.	Dy nene nga ndryshimet ligjore në Ligjin Nr. 30/2024 specifikojnë grumbullimin e të dhënave përmes raportimit nga institucionet publike qendrore dhe lokale, strukturat akomoduese, operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit. Për më tepër, është krijuar “Komiteti i statistikave të Turizmit” si një organ koordinues nën ministrinë përgjegjëse për turizmin, i cili kryesohet nga Ministri. Kjo qasje përmirëson hartimin e politikave dhe strategjive përmes analizës së të dhënave reale dhe ofron një pamje më të saktë mbi informalitetin në turizëm.	Sektori i turizmit përbën afërsisht 15% të të gjithë industrisë së shërbimeve dhe kontribuon në 17% të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik të Shqipërisë. Ajo kontribuon drejtpërdrejt me 8.5% në PBB, punëson rreth 20% të fuqisë punëtore kombëtare në vend. Investimet në këtë sektor përbëjnë rreth 7.5% të të gjitha investimeve në vend. ¹⁰

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
BUJQËSIA DHE AGROPËRPUNIMI		
Përditësimi në kohë dhe transparencë lidhur me hartat digjitale të tipeve të tokave bujqësore që udhëzojnë fermerët të mbjellin aty ku toka është më e përshtatshme.	Të dhëna dhe informacion specifik janë gjeneruar për të ndihmuar prodhuesit bujqësorë, për më shumë efektivitet, rritje të produktivitetit, ulje të kostove, udhëzime për përdorimin e plehrave bujqësore, efikasitetin e skemave të ujitjes dhe drenazhit, si dhe për reduktimin e ndotjes mjedisore. Sipas Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka përfunduar tashmë: Inventarizimi dhe klasifikimi i tokave bujqësore sipas përshtatshmërisë së tyre. Mbledhja e informacionit mbi përdorimin e tokës për vitin kur është bërë regjistrimi fillestar dhe për vitin 2023, si dhe analiza e dinamikës së ndryshimeve në përdorimin e tokës bazuar në paracela. Studimi agro-ekologjik i zonave të studimit. Digjitalizimi i regjistrit të tokave bujqësore për bashkitë Berat, Delvinë, Finiq, Kolonjë, Kuçovë, Lushnjë, Roskovec dhe pjesërisht Vlorë dhe Fier¹¹. Ndërsa për Korçën, të dhënat pritej të ishin të aksesueshme deri në Dhjetor 2024. Krijimi i programit WEB-GIS për të dhënat e tokës dhe përditësimi me të dhënat e këtyre bashkive. Ky sistem është i aksesueshëm nga çdo individ përmes E-Albania. Ky program u realizua në bashkëpunim midis Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AKSHI dhe Qendrës për Transferimin e Teknologjisë Bujqësore.	Me ndërmarrjen e kësaj nisme, do të krijohet një mjedis më i favorshëm për zhvillimin e bujqësisë, duke siguruar një kuadër transparent dhe të mbrojtur për 84,000+12 fermerë dhe investitorë që operojnë në sektorin e bujqësisë.
Incentivimi i bashkëveprimit të fermerëve, përmes grupeve të përbashkëta fermerësh ose (SHBB)	Disa nga incentivat e raportuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë: Në Skemën Kombëtare të Mbështetjes për vitin 2024, janë parashikuar dispozita speciale për të prioritarizuar "Grupet e Fermerëve" dhe Shoqëritë Bashkëpunuese Bujqësore (SHBB). Këto grupe përfitojnë të parat nga masat mbështetëse pa aplikuar parimin e proporcionalitetit ose kufizimet e përfitimeve, por duke marrë mbështetje të plotë në nivelin 100%. Po ashtu, mbështetja për bimët mjekësore dhe aromatike (MAP), një sektor bujqësor me orientim eksporti dhe potencial të lartë, është përfshirë sërish në skemën e vitit 2024. Për më tepër, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) po zhvillon një skemë të garancisë sovrane për të mbështetur huamarrjen në sektorin agroushqimor. Kjo skemë, në bashkëpunim me bankat dhe institucione të tjera financiare, përfshin grante për të ulur normat e interesit dhe incentiva për të inkurajuar bashkimin e operatorëve të biznesit.	Në skemën e fundit Kombëtare të Mbështetjes për vitin 2024, janë regjistruar 321 aplikime nga grupet e fermerëve, që përfshijnë gjithsej 1685 fermerë, dhe 21 aplikime nga Shoqëritë Bashkëpunuese Bujqësore (SHBB).

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
Formalizimi në sektorin bujqësor përmes përfundimit të regjistrimeve të fermave e fermerëve, si dhe lëshimit të Kartave të Fermerëve. Qasje më e mirë ndaj qeverisjes dhe politikbërjes të bazuara në të dhëna në bujqësi dhe përpunimin bujqësor, përmes përmirësimit të mbledhjes, përpunimit, shkëmbimit dhe analizës së të dhënave brenda këtyre sektorëve.	Sipas Urdhrit Nr. 6, datë 7.03.2024, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administratimit të fondeve të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural," të gjithë aplikantët duhet të përfundojnë ose përditësojnë regjistrimin e fermës përpara se të aksesojnë masat mbështetëse nga Skema Kombëtare. Regjistri i Fermës vazhdon të përditësohet shpesh nga fermerët që përfitojnë nga Skema Kombëtare 2024. Për të lehtësuar ndërveprimin ndërmjet Regjistratit të Fermës dhe regjistrave të tjerë kombëtarë dhe bazave të të dhënave elektronike, Regjistri i Fermës është integruar në sistemin AZHBR për aplikimet online për pagesat direkte në kuadër të Skemës Kombëtare. Ky integrim është zhvilluar me mbështetje nga AKSHI, duke siguruar shkëmbimin e të dhënave dhe ofrimin e shërbimeve në mënyrë efikase. Në MBZHR, me ndryshimin e strukturës organizative për vitin 2024, u krijua Departamenti i Statistikave, Analizës dhe Raportimit, që menaxhon dy sektorë (nga një sektor aktiv më parë, para ndryshimeve). U dakordua bashkëpunimi formal me institucione të tjera që merren me raportimin (si INSTAT) dhe gjithashtu me donatorët potencialë për përmirësimin metodologjik. Analiza sektoriale dhe orientimi i politikave: kjo përfshin identifikimin e trendeve, vlerësimin e ndikimeve të politikave dhe planifikimin e ndërhyrjeve në mënyrë efektive.	Sipas raportit të MBZHR, të dhënat për rreth 133,000 fermat aktive të autorizuara nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësore janë korrigjuar dhe përditësuar.

11 Mbi 65.2% e totalit të tokës bujqësore në vend.

12 <https://www.instat.gov.al/media/11652/regjistrat-e-biznesit-2022.pdf>

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
SEKTORI I AGROPËRPUNIMIT		
Promovimi i bashkëpunimit rajonal, krijimi i sinergjive për potenciale të reja për rajonin me lëvizjen e lirë të mallrave, punëdhënësve dhe kapitaleve, si dhe lehtësimi i barrierave jotarifore.	- Autoriteti fitosanitar shqiptar ka negociuar dhe arritur marrëveshje me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për njohjen dhe pranimin e ndërsjellë të certifikatave fitosanitare që shoqërojnë eksportet e produkteve bujqësore. Në kuadër të zbatimit të Protokollit Shtesë 5 - CEFTA, projekti SEED+ ka mundësuar testimin e lëshimit elektronik të certifikatave fitosanitare përmes platformës CEFTA TRACES NT.	Certifikata fitosanitare shqiptare njihet dhe pranohet nga të gjitha vendet e botës, pasi ajo është në përputhje me modelin e certifikatës fitosanitare të IPPC (Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve).
	- ISUV është mbështetur financiarisht për rritjen e kapaciteteve laboratorike dhe teknike për akreditimin e metodave të analizës së produkteve bujqësore. Analizat e kryera në ISUV janë të akredituara bazuar në normat e përcaktuara sipas acquis të BE-së. Aktualisht, ISUV është në procesin e akreditimit për mbetjet e pesticideve në BMA, proces i pritur për të përfunduar në fund të vitit 2024 (Grupi 6 sipas «Aneksit A. në Dokumentin SANTE N° 11312/2021»).	
	- MBZHR, në bashkëpunim me partnerë të tjerë, ka organizuar pjesëmarrjen e prodhuesve dhe kompanive eksportuese shqiptare në panaire të shumta jashtë vendit, kryesisht për fruta dhe perime, bimë mjekësore aromatike, verë, etj.	

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
GJITHË SEKTORËT		
Miratimi i një direktive të re për shmangien e taksimit të dyfishtë përmes automatizimit dhe procedurave elektronike, që ndikojnë në parandalimin e evazionit fiskal.	Rekomandimi u materializua në dy dokumente kryesore: Udhëzimi Nr. 11 i Ministrisë së Financave, datë 23.07.2024, me titull "Për Zbatimin e Marrëveshjeve për Shmangien e Taksimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal," si dhe Udhëzimi Plotësues Nr. 11/1, datë 27.11.2024. Këto dokumente përcaktojnë standardet për zbatimin e marrëveshjeve dhe modernizojnë formatin e dokumentacionit të kërkuar. Ato mundësojnë njohjen e certifikatave dhe formularëve të nënshkruar elektronikisht në një format të digjitalizuar, duke lehtësuar proceset për tatimpaguesit dhe administratën tatimore, ndërkohë që forcojnë përpjekjet për të luftuar evazionin fiskal.	Dy ndryshimet ligjore prekin të gjitha kompanitë që janë objekt i procedurave të taksimit të dyfishtë. Ato përcaktojnë kriteret dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal. Marrëveshjet për shmangien e taksimit të dyfishtë mundësojnë eliminimin e taksimit të dyfishtë duke përcaktuar se cili nga shtetet ka të drejtën e taksimit të disa të ardhurave të një subjekti ose personi fizik, ose duke ndarë këtë të drejtë mes dy vendeve, por pa e ngarkuar tatimpaguesin me taksim të dyfishtë. Gjithashtu, këto marrëveshje synojnë të parandalojnë evazionin fiskal përmes shkëmbimit të informacionit për të gjithë personat fizikë ose subjektet që ushtrojnë aktivitet në të dy vendet mes të cilave është lidhur Marrëveshja.
Digjitalizimi i shërbimeve bankare dhe implementimi i 'Open Banking' me licencimin e institucionit të parë të Open Banking, duke përmirësuar aksesin në financa dhe konkurrencën në treg.	Përsheptimi i digjitalizimit të shërbimeve bankare dhe adoptimi i parimeve të "Open Banking" u konkretizua më 26 Nëntor 2024, me dhënien e licencës institucionit të parë zbatues të Open Banking nga Banka e Shqipërisë (Easy Pay).	Kjo nismë u mundëson individëve dhe kompanive të aksesojnë dhe të ndajnë në mënyrë të sigurtë të dhënat e llogarive të tyre. Gjithashtu, u lejon përdoruesve të kryejnë pagesa përmes ofruesve të shërbimeve të palëve të treta, duke përmirësuar aksesin në shërbimet financiare dhe duke nxitur konkurrencën në treg, veçanërisht për popullsinë e nënpërfaqësuar që nuk ka akses të plotë financiar.

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
Progres në Reformën e Inspektimeve me miratimin e Ligjit nr. 99/2024, duke integruar reformat strukturore dhe forcimin e kapaciteteve, ndërsa trajton unifikimin dhe centralizimin e apelimit për rritjen e profesionalizmit dhe besimit.	Reforma e Inspektimit, si një element kyç i agjendës deregulatore, arriti një moment të rëndësishëm me miratimin e Ligjit Nr. 99/2024, datë 12 shtator 2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Ky ligj integron plotësisht masat e rekomanduara, duke forcuar përpjekjen për harmonizimin e inspektimeve me reformat strukturore si administrata publike dhe standardet ligjore të BE-së. Ai thekson forcimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore dhe presanton mekanizma të strukturuar konsultimi me bizneset për të vlerësuar ndikimin e parashikuar të ndryshimeve rregullatore, duke siguruar përfshirjen dhe efektivitetin e reformës. Për më tepër, forcon rekomandimin për unifikimin dhe centralizimin e procesit të ankimit të Inspektorateve nën Inspektoratin e Përgjithshëm, me qëllim rritjen e profesionalizmit, pavarësisë dhe besueshmërisë.	Këto ndryshime ligjore ndikojnë të gjitha kompanitë që operojnë në Shqipëri, si subjekte të inspektimeve nga disa inspektorate që veprojnë nën udhëheqjen e Inspektoratit të Përgjithshëm.
Miratimi i "Strategjisë Afat-Mesme të të Ardhurave për Periudhën 2024-2027 dhe Planit të Veprimit 2024-2027"	Kjo strategji u miratua përmes aktit normativ VKM nr. 847 më 24 dhjetor 2024. Dokumenti përcakton masa dhe iniciativa të ndryshme që synojnë përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe formalizimin, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe nxitjen e ndërtimit të kapaciteteve.	Strategjia ndikon të gjitha kompanitë që operojnë në Shqipëri. Masat kryesore që përputhen gjithashtu me rekomandimet e KI-së, të sugjeruara gjithashtu gjatë fazës së konsultimit të strategjisë, përfshijnë uljen e pagesave në para kesh përmes reformave në administratën tatimore, inkurajimin e përdorimit të sistemeve POS përmes diskutimeve me sektorin bankar, dhe analizimin e sektorëve me rrezik të lartë si ndërtimi, turizmi dhe tregtisë elektronike për informalitetin. Gjithashtu, theksohet përmirësimi i koordinimit ndër-institucional për të trajtuar punën e pa deklaruar, rritja e ndërgjegjësimit publik për përfitimet e kontributeve shoqërore dhe forcimi i shërbimeve për tatimpaguesit përmes përmirësimit të qendrave të thirrjeve dhe trajnimit të stafit. Masat e tjera përqendrohen në forcimin e politikave për efikasitetin e energjisë, parandalimin e tatimit të dyfishtë dhe përputhjen e ligjeve tatimore vendore me standardet e BE-së.

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
Miratimi i "Agjendës Kombëtare të Reformës 2024-2027" brenda instrumentit të Bashkimit European "Mekanizmi i Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor".	Kjo reformë u miratua përmes aktit normativ VKM nr. 621 në Tetor 2024. Reforma e miratuar është një plan veprimi i bazuar në objektiva trevjeçarë, me angazhimin për t'u realizuar sipas "Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor" të BE-së, i miratuar më 8 nëntor 2023. Ky plan është i dizajnuar për të afruar rajonin më pranë anëtarësimit në BE duke ofruar përfitime konkrete dhe mbështetje financiare për të përshpejtuar konvergjencën socio-ekonomike dhe integrimin në tregun e përbashkët të BE-së. "Mekanizmi i Reformës dhe Rritjes për WB6" u miratua në maj 2024, si një instrument i ri për mbështetje të reformave të lidhura me BE-në dhe rritjen ekonomike në rajon. Ai do të mbulojë periudhën nga 2024 deri në 2027 dhe pritet të ofrojë deri në 2 miliardë euro grante dhe 4 miliardë euro hua për gjashtë partnerët e Ballkanit Perëndimor në vitet në vijim. Ai thekson nevojën që vendet e Ballkanit Perëndimor të modernizojnë ekonomitë e tyre dhe të investojnë në infrastrukturë, me një fokus të veçantë në sektorë si arsimi dhe zhvillimi i aftësive që mund të veprojnë si shumëzues kyç për progresin socio-ekonomik.	Reforma ndikon në klimën e përgjithshme të biznesit dhe të gjitha kompanitë që operojnë në Shqipëri, mbi 125,000 ndërmarrje ekonomike. Shtyllat kryesore, që përputhen gjithashtu me rekomandimet e IC-së, përfshijnë modernizimin e klimës së biznesit me strategji të përditësuara të të ardhurave, digjitalizimin e sistemeve kadastrale dhe miratimin e ligjeve për investimet të përputhura me standardet e BE-së. Në kapitalin njerëzor, reformat synojnë përputhjen e arsimit dhe trajnimit profesional me nevojat e tregut të punës përmes kurikulave të përditësuara, miratimit të Strategjisë për Specializimin e Zgjuar dhe krijimin e Laboratoreve Smart Përpjekjet për digjitalizim kanë si prioritet shtrirjen e infrastrukturës së sigurt 5G dhe implementimin e skemave të granteve për zgjidhje të gjelbra dhe digjitale për SME-të dhe startup-et. Në sektorin e energjisë, fokusi është në operacionalizimin e tregjeve të energjisë brenda dite për të avancuar kalimin në gjelbër të Shqipërisë.
Digjitalizimi i shërbimeve publike administrative lokale për bizneset që operojnë në nivel lokal.	Në korrik 2024, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI/NAIS) thekson se, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Qeverisjen Vendore, po negocion me Bankën Botërore për mundësi financimi shtesë.	Qëllimi është të zgjerohet bashkëpunimi ekzistues për të përfshirë riorganizimin administrativ, transformimin digjital, modernizimin e financave lokale dhe integrimin e qeverisjes vendore në infrastrukturën digjitale të qeverisë qendrore.

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
Mundësimi i sistemit të pagesave online për shërbimet administrative qendrore.	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë (BSH), Shoqatën e Bankave dhe bankat tregtare në Shqipëri, suportuar nga Ministria e Financave, ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për Projektin e Digjitalizimit të Pagesave Elektronike për shërbimet publike. Prej më shumë se një vit, bankat tregtare po zhvillojnë kapacitete teknike për të mundësuar pagesat online përmes kanaleve të tyre bankare për shërbimet elektronike në portalin e-Albania.	Aktualisht, 17 shërbime online në portalin e-Albania mbështesin pagesat online përmes kanalit të e-banking-ut, ku aplikantët mund të zgjedhin bankën e tyre dhe të kryejnë pagesat përmes aplikacionit mobil të bankës së tyre. Deri tani, vetëm "Banka Kombëtare Tregtare - BKT" ka përfunduar zhvillimet teknike të nevojshme, dhe pagesat online për 17 shërbimet elektronike tani janë të disponueshme përmes këtij kanali. Testimi dhe lançimi i funksionalitetit të pagesave online për shërbimet e mbetura nga bankat e tjera janë në proces.
Lehtësimi i procesit të ndërmjetësimit të punësimit	Sipas raportimeve nga AKPA, platforma puna.gov.al përditësohet rregullisht me vendet e lira të punës dhe tipologjitë e punëve variojnë në disa sektorë. Takime rajonale janë mbajtur mes institucioneve nën AKPA si Zyrat e Punes, QFP dhe Shkollat e Arsimit Profesional, si dhe takime informuese me palët e interesuara, duke inkurajuar pjesëmarrjen në shërbimet dhe programet që ofron AKPA.	Platforma puna.gov.al ka si qëllim të rrisë ndërveprimin midis punëdhënësve dhe kërkuesve të punës, ku këta të fundit mund të aplikojnë drejtpërdrejt për vendin e punës pa pjesëmarrjen e Zyrës së Punes.

Rekomandime	Arritje	Impakti i Pritshëm
Ndikimi në besimin në platformat online duke përmirësuar sigurinë e informacionit që shkëmbehet në platformat digjitale ku ofrohen shërbime administrative.	AKSHI ka hartuar dhe miratuar dokumentin "Udhëzime për Zbatimin e Dokumentit të Përditësuar të Vazhdueshmërisë dhe Planit për Ruajtjen e Informacionit". Ky dokument përshkruan masa gjithëpërfshirëse për të siguruar një kopje rezervë dhe rikuperim të shpejtë të sistemeve dhe të dhënave në rast të sulmeve kibernetike ose ndërprerjeve të tjera. Shtrirja e këtyre udhëzimeve përfshin protokolle për rikuperimin e të dhënave, aplikacioneve dhe sistemeve teknologjike për të ruajtur kontinuitetin operacional gjatë ndërprerjeve të shërbimeve ose fatkeqësive si incidentet kibernetike, zjarret, rrjedhjet e ujit ose incidente të tjera të lokalizuara. Për më tepër, AKSHI është aktualisht duke implementuar një zgjidhje për Parandalimin e Humbjes së Të Dhënave (DLP) për të klasifikuar dhe etiketuar të dhënat bazuar në rëndësinë e tyre. Kjo zgjidhje është implementuar plotësisht nga AKSHI dhe është zbatuar pjesërisht në institucione të tjera shtetërore si një hap fillestar bazuar në marrëveshje të caktuara. Klasifikimi i të dhënave përfshin tre etiketa të përcaktuara: të Përgjithshme, të Kufizuara dhe Konfidenciale, secila me specifikime që mund të rregullohen nga institucionet për t'u përputhur me nevojat e tyre operative, duke ruajtur një nivel bazë ndjeshmërie për informacionin e klasifikuar automatikisht.	Fokusi është në mbrojtjen e informacionit dhe sigurimin e disponueshmërisë së shërbimeve përmes bashkëpunimit me institucione të tjera dhe palë të treta, siç përcaktohet nga kuadrot ligjore ose marrëveshjet. Këto iniciativa tregojnë angazhimin e AKSHI-së për të forcuar besimin në platformat online duke adresuar proaktivisht rreziqet e sigurisë kibernetike dhe duke zbatuar masa të forta për mbrojtjen e të dhënave në të gjithë shërbimet administrative.

SHTOJCA 1

LISTA E DOKUMENTAVE TË KONSULTUARA:

- » Ligji Nr. 30/2024, që sjell ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 93/2015, “Për Turizmin”, i ndryshuar
- » Ndryshimet në VKM Nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e llojeve, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, magazinimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe të produkteve të blegtorisë, në terren bujqësor”.
- » Ligji Nr. 99/2024, datë 12.9.2024 «Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë».
- » Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 11/1, datë 27.11.2024 «Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 11, datë 23.7.2024, ‘Për zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal».
- » VKM Nr. 695, datë 13.11.2024 “Për miratimin e masave mbështetëse, rregullave dhe procedurave për përfitimin e masave mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme”.
- » VKM Nr. 696, datë 13.11.2024 “Për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësisë të Operatori të Energjisë Rinovueshme SH.A” duke detajuar përgjegjësitë dhe funksionimin e kësaj strukture.
- » VKM Nr. 847, datë 24 dhjetor 2024 “Strategjia Afat-Mesme e të Ardhurave 2024-2027 dhe Plani i Veprimtimit 2024-2027”.
- » VKM Nr. 621, tetor 2024, “Agjenda Kombëtare e Reformës 2024-2027” brenda instrumentit të Bashkimit Europian “Mekanizmi i Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor”.
- » Dokumenti i ‘Prioriteteve të Politikave të Konkurrueshmërisë’ i përgatitur nga EBRD.

LISTA E INSTITUCIONEVE TË KONTAKTUARA ZYRTARISHT:

- » Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- » Ministria e Shtetit për Qeverisjen Vendore
- » Ministria e Shtetit për Ndërmarrësinë dhe Klimën e Biznesit
- » Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- » Ministri i Shtetit për Antikorrupsionin dhe Administratën Publike
- » Agjencia për Zhvillimin Bujqësor Rural
- » Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- » Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
- » Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
- » Agjencia Shtetërore e Kadastrës
- » Agjencia për Inovacionin dhe Ekselencën

LISTA E TË DHËNAVE SEKONDARE TË KONSULTUARA PERIODIKISHT:

- » <https://www.konsultimipublik.gov.al/>
- » <https://kryeministria.al/>
- » www.akademi.al
- » <https://qbz.gov.al/>
- » <http://aida.gov.al/sq/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://www.parlament.al/Projektligje/IndexList>
- » <https://invest-in-albania.org/>
- » <https://www.ashk.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <http://www.azht.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://globaldigitalcity.com/>
- » <https://www.financa.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://www.infrastruktura.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://arsimi.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://bujqesia.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://shendetesia.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://turizmi.gov.al/> (dhe FB, Instagram)
- » <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/projects/star-3---consolidation-of-the-territorial-and-administrative-ref.html>
- » <https://bit.ly/3aB5f47>
- » <https://eu4municipalities.al/fillon-zyrtarisht-projekti-be-per-bashkite-per-mbeshtetjen-e-bashkive-shqiptare-dhe-komuniteteve-lokale-ne-procesin-e-integrimit-evropian/>
- » <https://financat-lokale.al/sq/node/89>
- » Artikuj të ndryshme në Revistën Monitor, Business Magazine, Exit.al, Balcan Web, News 24, Exit.Al, etj.



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

www.investment.com.al

RAPORT MONITORIMI I REKOMANDIMEVE 2024